



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Prot. Nr. _____

30 Gusht 2017, Tiranë

Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Projekti “Shoqëria Civile kundër ekstremizmit të dhunshëm”

Skema e Granteve të Vogla

Numri i Referencës EuropeAid/152207/DD/ACT/AL

Vendim për shtyrjen e afateve

Bazuar në procedurat e përcaktuara në manualin e Skemës së Granteve të Vogla, Pika 5, Staf i Menaxhimit të Projektit u mblodh për të rivlerësuar afatet e parashikuara në pikat 7, 8 dhe 9 të tabelës orientuese të afateve në kuadër të thirrjes për projekt propozime “Shoqëria Civile kundër ekstremizmit të dhunshëm”, lancuar në datë 12 Qershor 2017, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian.

Duke vërejtur se, ka një numër të madh të aplikimeve që kanë kaluar në fazën e vlerësimit teknik dhe periudha në dispozicion të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, nga data 21 deri në datën 25 Gusht 2017 ishte objektivist e pamjaftueshme për të përmbyllur në mënyrë të plotë të gjithë procedurën dhe dokumentacionin e vlerësimit teknik të projekt-aplikimeve, stafi i menaxhimit të projektit në konsultim me anëtarët e Komisionit të Vlerësimit dhe me miratimin e Drejtorit Ekzekutiv të KShH-së. :

Vendosi:

Të shtyjë afatin e vënë në dispozicion për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit për mbylljen e të gjithë procedurës së vlerësimit teknik. Ky afat do të publikohet në faqen e internetit dhe FB e KShH-së në ditët në vijim, deri në bashkërendimin e një date konsensuale mes anëtarëve të këtij Komisioni. Shtyrja e këtij afati, passjell shtyrjen e afateve të tjera të parashikuara në tabelën orientuese të afateve (pikat 7, 8 dhe 9) për njoftimin e rezultateve, shpalljen e fituesve dhe negocimin/kontraktimin e aplikantëve fitues.

Stafi i Menaxhimit të Projektit

Klejda Ngjela
Valmira Kallushi

Miratoi Vendimin:

Erida Skëndaj,
Drejtoreshë Ekzekutive